



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME
DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME**

DATA/DATUM/DATE	20.02.2023
NR/BR/NO	03/02
PËR/ZA/TO	Kuvendi Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH	Kryetari i Komunës- z. Qemajl ALIUMES
NGA/OD/FROM	Drejtoria për Adminsitratë të Përgjithshme, z. Valon JANUZI, Kordinatori i Grupit Punues për hartimin e Planit të Integritetit për Komunen e Shtimes
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Draft-Plani komunal për Integritetit 2023-2027

Në mbështetje të agjendës për integrime evropiane dhe kërkesave që dalin si kritere obliguese për komunat, bazuar në vendimin e themelimit të grupit punues nga Kryetari i Komunës për hartimin e Planit të Integritetit për Komunën e Shtimes për periudhën 2023-2027, datë 27.02.2022, Nr. protokolli 02/296, bashkëngjitur gjeni draft materialin e Planit të Integritetit për të vazhduar me procedurat e mëtutjeshme, fillimisht të dalë në dëgjim publik dhe më pas për miratim në Kuvend.

Plani i Integritetit është dokument strategjik dhe operativ, që bazohet në rezultatet e procesit të vlerësimit të rrezikut për integritet për të gjitha proceset e punës në institucionet komunale, si dokument i brendshëm miratohet përmes Kuvendit Komunal.

Dokumentin e plotë do ta gjeni të bashkangjitur me materialin e Kuvendit, ndërsa prezantimin do ta bëjmë në mbledhjen e Kuvendit. Ju ftojmë që ta miratoni vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik.